



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1972/Prot.
3

Tiranë, më 09.06.2022

URDHËR

Nr. 261, datë 09.06.2022

“PËR

**PËRCAKTIMIN E MODALITETEVE TË EVIDENTIMIT DHE HAPAVE QË
DUHEN NDJEKUR PËR MARRJEN NË DORËZIM TË ARKIVAVE TË
PADORËZUAR ENDE NDËR VITE NGA ISH-PËRMIBARUESIT GJYQËSORË
PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 88, pika 6 të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë kryen verifikimin në regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë, duke evidentuar në një listë përmbaruesit gjyqësorë privatë të cilëve u është hequr certifikata e aftësisë profesionale të përmbaruesit gjyqësor privat dhe janë çregjistruar nga regjistri sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi në kohën e çregjistrimit, për të cilët në regjistar nuk ka të dhëna për marrjen në dorëzim të arkivës.
2. Për përmbushjen e detyrimit të mësipërm, Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë, pasi kryen verifikimet përkatëse, nxjerr nga arkiva të gjithë urdhrat e Ministrisë të Drejtësisë për çregjistrimin nga regjistri i përmbaruesve gjyqësorë privatë për një nga

shkaqet ligjore perkatëse, si dhe për dorëzimin e dokumentacionit të krijuar për çdo veprim procedural të kryer.

3. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë mund të kërkojë bashkëpunimin e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë për të evidentuar nëse arkivat janë marrë në dorëzim nga Ministria e Drejtësisë.
4. Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, nëse ka dijeni, detyrohet të informojë Ministrinë e Drejtësisë për mbajtjen e arkivave të padorëzuara nga persona të tretë.
5. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë identifikon ish-përmbauesit gjyqësorë privatë që kanë ndërruar jetë, si dhe trashëgimtarët e tyre ligjorë apo testamentarë që mund të jenë në dijeni apo kanë marrë në ngarkim arkivën e padorëzuar.
6. Për përmbushjen e detyrimit në pikën 5 të këtij urdhri, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë kërkon bashkëpunimin e Zyrtarëve të Gjendjes Civile për dërgimin e certifikatave familjare të ish-përmbauesve gjyqësorë privatë për të identifikuar personat që mund të jenë në dijeni apo kanë marrë në ngarkim arkivën e padorëzuar.
7. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë mund të kërkojë informacione nga subjekte të tjera publike a private, të cilat kanë detyrimin për dhënien e informacionit të kërkuar, sipas afatit të përcaktuar nga Drejtoria në kërkesën e tyre.
8. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet Drejtërisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë dhe subjekteve të mësipërme bëhet sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke vlerësuar në çdo rast koston dhe efektivitetin për kryerjen e procesit të identifikimit të ish-përmbauesve gjyqësorë privatë apo të personave të tjerë në zbatim të këtij urdhri.
9. Në rastet kur përmbauesit gjyqësorë privatë i është hequr licenca dhe është çregjistruar për shkak të dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, ekzekutimi i të cilit nuk ka përfunduar ende, ose për shkak të humbjes së zotësisë për të vepruar, arkiva dorëzohet nga një i afërm i tij.
10. Pas evidentimit të listës shtruese të ish-përmbauesve gjyqësorë privatë që nuk kanë dorëzuar arkivin pranë Ministrisë së Drejtësisë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve pune, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë njofton me postë të porositur dhe/ose në rrugë elektronike ish-përmbauesit gjyqësorë privatë apo personat e tretë për dorëzimin e arkivës në mënyrë vullnetare,

- duke përcaktuar ditën dhe orën e dorëzimit. Personi përkatës njoftohet të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara për ditën dhe orën e dorëzimit të arkivit në Ministrinë e Drejtësisë.
11. Në rastet kur nuk vendbanimi nuk dihet dhe kur njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të Kodit të Procedurave Administrative, ndiqen rregullat për njoftimin publik sipas nenit 162 të këtij Kodi.
 12. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, bëhet verifikimi fizik i tyre nga nëpunësi i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë duke i numëruar fletë për fletë, si dhe duke mbajtur shënime për çdo parregullsi të hasur.
 13. Për dorëzimin e arkivës mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga ish-përmbaruesi gjyqësor privat ose personi i autorizuar për dorëzimin e tyre apo personi i tretë dhe nga nëpunësi i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, i ngarkuar për të marrë në dorëzim arkivën.
 14. Procesverbali hartohet në 3 (tri) kopje, prej të cilave një kopje mbahet në Ministrinë e Drejtësisë, një nga ish-përmbaruesi gjyqësor/personi që dorëzon arkivën dhe një kopje i dërgohet për dijeni Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.
 15. Në rast se ish-përmbaruesi gjyqësor/personi që dorëzon arkivën refuzon nënshkrimin e procesverbalit, nëpunësi i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë bën shënimin përkatës në procesverbal dhe kur është e mundur, e vërteton me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm faktin e refuzimit të nënshkrimit.
 16. Arkivi i marrë në dorëzim sipas përcaktimeve të këtij urdhri i dorëzohet me procesverbal nga nëpunësi i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë i ngarkuar për të marrë në dorëzim arkivën, Sektorit të Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë.
 17. Në rast mozbatimi vullnetar, urdhri i Ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e arkivit përbën titull ekzekutiv. Ministria e Drejtësisë merr masa për ndjekjen e procedurave ligjore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit mbi titullin ekzekutiv. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë i kërkon Sektorit të Përfaqësimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Sektori i Përfaqësimit Gjyqësor paraqet në gjykatë kërkesën brenda 20 (njëzet) ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar sipas pikës 10 ose 11 të këtij urdhri. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë i kërkon shërbimit përmbarimor gjyqësor vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.
 18. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

19. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njohimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

